

VENDIM
Nr.275, datë 10.5.2006

**PËR LEJIMIN E DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË RRUGËVE TË PËRDORË
PROCEDURAT E PROKURIMIT TË BANKËS BOTËRORE PËR OBJEKTET
“STUDIMI I PARAFIZIBILITETIT TË BOSHTIT QENDROR – JUGOR” DHE
“SUPERVIZIONI I PUNIMEVE TË NDËRTIMIT TË RRUGËS KALIMASH- KUKËS-
MORINË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës të neneve 3 e 17 pika 5 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006” me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve të përdorë procedurat e prokurimit të Bankës Botërore “Zgjedhja dhe punësimi i konsulentëve të huamarrësve të Bankës Botërore, publikuar në maj të vitit 2004, duke përdorur metodën e analizës së cilësisë dhe kostos (QCBS)”, për objektet e mëposhtme:

a) “Studimi i parafizibilitetit të boshtit Qendror-Jugor, me vlerë të plotë 25 000 000 (njëzet e pesë milionë) lekë nga të cilat: 4 000 000 (katër milionë) lekë janë programuar në buxhetin e vitit 2006, miratuar për Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, zëri “Studim-projekte”, ndërsa diferenca të programohet në buxhetin shtesë të vitit 2006 për këtë ministri në zbatim të nenit 12 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”.

b) “Supervizioni i punimeve të ndërtimit të rrugës Kalimash-Kukës-Morinë”, me vlerë të plotë 160 000 000 (njëqind e gjashtëdhjetë milionë) lekë. Financimi të bëhet në përputhje me ecurinë e investimeve.

Studimi i parafizibilitetit të boshtit Qendror-Jugor të përfundojë brenda vitit 2006.

Kohëzgjatja e supervizionit të punimeve të ndërtimit të rrugës Kalimash-Kukës-Morinë të jetë në varësi të kontratave të punimeve të ndërtimit.

Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha